

Udhëzimi për bërë të QPZ
dtë 08.01.2019.

Juridik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 36 prot.

Tiranë, më 04.01.2019

UDHËZIM

Nr. 02, datë 04.01.2019

PËR

**KRIJIMIN E REGJISTRIT TË NDËRMARRJEVE SOCIALE DHE
RREGULLAT PËR MBAJTJEN E TIJ**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 15, pika 2, të Ligjit Nr.65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Regjistri i ndërmarrjeve sociale, këtu e në vijim i përmendur shkurtimisht si “Regjistri”, është baza elektronike e të dhënave, për subjektet kanë marrë statusin e ndërmarrjes sociale.
2. Regjistri funksionon sipas parimit të të përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave dhe informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.
3. Regjistri mbahet në format elektronik dhe është publik.
4. Regjistri krijohet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet nga Ministria që është përgjegjëse për çështjet sociale.
5. Regjistri duhet të përmbajë të dhëna që lidhen me themelimin e subjektit si organizatë jo-fitimprurëse, përfaqësuesin ligjor dhe informacionin e kontaktit, fushën e veprimtarisë së ndërmarrjes sociale, datën e marrjes së statusit, gjendjen e statusit të ndërmarrjes sociale nëpërmjet shkurtimeve “A” për statusin aktiv dhe “H” në rast të humbjes së tij. Regjistri duhet të reflektojë dhe çdo ndryshim për këto të dhëna.

6. Regjistrimi fillestar në regjistër bëhet nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale pa kërkesë apo njoftim nga subjekti që merr statusin e ndërmarrjes sociale, ndërsa çdo ndryshim në të dhënat e regjistrimit duhet të njoftohet me shkrim nga subjektet, brenda 10 ditëve kalendarike, në Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë.

7. Të dhënat e regjistrimit nuk përbëjnë të dhëna personale ose sekret tregtar.

8. Të dhënat e subjekteve që e kanë humbur statusin, ruhen në regjistër për 5 vjet.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

